

PETRIT VASILI



Datëlindja: 04.06.1958

Vendlindja: Tiranë

Email: petrit.vasili@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka lindur në Tiranë, më 4 qershor 1958. Pasi kreu studimet në Universitetin e Tiranës për Mjekësi në vitin 1983, Z. Vasili përfundoi specializimin e plotë universitar në po të njëjtin Universitet në vitin 1985. Nga viti 1988- 1991 ka ndjekur Doktoraturën në Institutin Prestigjoz “ Instituto Superiore Sanita” në Romë, Itali.

Z. Vasili ka një aktivitet të gjatë profesional ashtu edhe politike pasi ka punuar në institucione dhe ka mbuluar pozicione të ndryshme, si punonjës dhe më pas Shef i Sektorit të Higjenës, Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor gjithashtu ka mbuluar dhe disa pozicione politike si Zëvendësministër i Shëndetësisë, Ministër i Shëndetësisë, Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministër Drejtësie.

Ai ka një aktivitet të pasur shoqëror dhe politik që nga viti 1992 deri më sot si: Anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Sekretar i Komisionit të Shëndetësisë në PS, Koordinator politik i Shqipërisë për shëndetësinë, në paktin për stabilitetin. Në vitin 2004 Z.Vasili zgjidhet Sekretar i Përgjithshëm i LSI-së, më pas Kryetar i grupit Parlamentar dhe në vitin 2017 kryetar i kësaj force politike. Aktualisht mban pozicionin e Nënkryetarit në partinë Lëvizja Socialiste për Integrim.

